



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 24, datë 31.10.2018

**Për miratimin e Statutit
të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave**

Në mbështetje të nenit 43, pika 1, shkronja “m/1”, të nenit 52 pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 12, pika 8, të nenit 15, pika 4, të nenit 20, pika 2 shkronja “ç”, të nenit 24, pika 4, të nenit 25 pika 5, të nenit 64, pika 2, shkronja “ç”, të nenit 71, pika 2 dhe 3, të neneve 73, 76, 77, 78, si dhe 79 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores nr.56, datë 3.10.2017 “Për Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij” të Bankës së Shqipërisë, të Politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, të miratuar me shkresë nr. 5587/1, datë 10.1.2018 të Bankës së Shqipërisë, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Të miratojë Statutin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të shfuqizojë Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 28, datë 03.11.2014 “Për miratimin e Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të ndryshuar.
3. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e statutit të miratuar me këtë vendim, në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar